



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 01-400/01-0016712/25
Data 02.05.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Bazuar në nenin 11 dhe neni 12 paragrafi 1, 2, shkronja d), neni 17, shkronja f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 8, shkronja a), dhe neni 15 shkronja f), të Ligjit Nr.03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 1, nën paragrafi 1.8, dhe neni 34, të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, dhe sipas neni 14 paragrafi 1, 2 shkronja d) i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, dhe sipas kërkesës së KRU “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë, me Nr.02-352/10-0008762/25, e datës 03.03.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.04.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

(Për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave, të ofruara nga KRM “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë, në Komunën e Skenderajt)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimit më Nr.02-352/01-0010872/25, i datës 24.03.2025, Për ngritjen e tarifës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave, të ofruara nga KRU “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë, në Komunën e Skenderajt.

Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi ngritën tarifat për shërbime për grumbullimin e mbeturinave, të ofruara nga KRU “Uniteti” Sh.A. Mitrovicë në komunën e Skenderajt, si në vijim;

- Nga (pesë **5€**), në (gjashtë **6€**), për ekonomi familjare rezident, dhe
- Nga (pesëmbëdhjetë **15€**), në (tetëmbëdhjetë **18€**), për ekonomi familjare jo-rezident.

Duke u ndryshuar dhe plotësuar neni 18 paragrafi 1.1, shtojca A, i Rregullores me Nr. 01-110/04-0005958/23, i datës 31.01.2023, për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Skenderajt.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Drejtoria për Buxhet e Financa, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përkatëse dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i Dërgohet:

- 1x1 Arkivit,
- 1x1 Zyrës së Kryetarit,
- 1x1 MAPL-së,
- 1x1 MF-së,
- 1x1 DBF-së,
- 1x1 KRM “Uniteti” Sh.A.
- 1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahiu





REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
Nr. Dokumenti: 02	Nr. Dokumenti: 37462/25
Nr. Fletës: 02	Nr. Fletës: 19.05.25
PRISHTINË / A	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Fadil Nura, Kryetar i Komunës së Skenderaj Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderaj
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 01-400/01-00161112/25 për ngritjen e tarifës së shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave, të ofruara nga KRM "Uniteti" SH.A Mitrovicë, në komunën e Skenderajt, datë 02.05.2025

I nderuar kryetar Nura,
E nderuara kryesuese Spahiu

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (MMPHI) në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.05.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Vendimi Nr. 01-400/01-00161112/25 për ngritjen e tarifës së shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave, të ofruara nga KRM "Uniteti" SH.A Mitrovicë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Skenderajt, datë 02.05.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Sa i përket aspektit të ligjshmërisë lidhur me Vendimin Nr. 01-400/01-00161112/25 për ngritjen e tarifës së shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave, të ofruara nga KRM "Uniteti" SH.A Mitrovicë, në komunën e Skenderajt nuk është kompetent MMPHI, për shkak se dispozitat e Ligjit për mbeturina nuk e përcaktojnë vlerën apo ngritjen e tarifës mirëpo këtë të drejtë apo kompetencë se si ta kalkulojë dhe përcaktoj tarifën e shërbimit publik për grumbullimin e mbeturinave në bazë të Ligjit e kanë Komunitat dhe si proces i tillë MMPHI nuk ndërhyr në këtë çështje.